



O O O O

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

# NEWSLETTER

MAJ

2025

## Vendimmarrjet e Bordit të ERE gjatë muajit maj

Gjatë muajit maj 2025, Bordi i ERE zhvilloi dy mbledhje vendimmarrëse, ku u shqyrtuan dhe miratuan 17 vendime në funksion të zhvillimit dhe rregullimit së tregut të energjisë.

## Licencime të reja

Më 12 maj 2025, shoqëria "NAD Investment" sh.p.k. u licencua nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE) për veprimtarinë e furnizimit dhe tregtimit të energjisë elektrike, për një periudhë 5-vjeçare. Kjo licencë i mundëson shoqërisë të operojë zyrtarisht në tregun e energjisë elektrike në Shqipëri, duke kontribuar në rritjen e numrit të pjesëmarrësve që kanë të drejtë të angazhohen në aktivitetet e tregtimit dhe furnizimit të energjisë.

## Procedura të filluara gjatë muajit maj

Gjatë muajit maj, Enti Rregullator i Energjisë (ERE) filloi procedurat për licencimin e shoqërisë "SunPro" sh.p.k., për zhvillimin e një centrali eolik me kapacitet instaluar prej 3 MW në Qarkun Vlorë. Ky kapacitet do të kontribuojë në furnizimin me energji të pastër, bazuar në burime të rinovueshme dhe të qëndrueshme.

Projekti parashikon instalimin e turbinave me teknologji moderne eolike, të përshtatura për kushtet klimatike dhe shpejtësinë mesatare të erës në zonën e Vlorës. Procedura e licencimit përfshin shqyrtimin e dokumentacionit teknik, mjedisor dhe financiar, dhe verifikimin e përputhshmërisë me legjislacionin në fuqi. Procesi në vijim duhet të përfundojë brenda 90 ditëve kalendarike nga data e fillimit të procedurës.

Ky projekt përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt rritjes së investimeve në sektorin e energjisë nga burime të rinovueshme në Shqipëri, duke mbështetur objektivat kombëtare për diversifikimin e burimeve të energjisë.

## Autorizime për garanci financiare

Bordi miratoi kërkesat e disa shoqërive për vendosjen e kuotave apo asetëve si garanci (hipotekë) ndaj institucioneve financiare, për të mbështetur investimet apo aktivitetet tregtare. Në këtë kuadër u miratuan autorizime për:

"5GX ENERGY" sha, "DELIU 3D" sh.p.k., "G.S.K." sh.p.k., "GREENNAT PARK SOLAR BALLSH" sh.p.k. dhe "INFO-TELECOM" sh.p.k.

Gjithashtu, filloi procedurën për shqyrtimin e kërkesave për autorizim për transferim asetesh për shoqëritë "HYDROPOWER" sh.p.k., "DIMAX ALBANIA" sh.p.k., "C.E.P." sh.p.k.

## Vendime të tjera

U shfuqizuan kushtet e vendimit nr. 85/2025 për "ALBESP TRADING & CONSULTING" sh.p.k., lidhur me ndryshimet në strukturën e ortakëve të saj.

## Publikime dhe konsultime publike

Janë publikuar të dhënat për funksionimin e tregut të energjisë elektrike për vitin 2024:

- Raporti 12-Mujor 2024

**PCT**  
ALBANIA

[www.ere.gov.al](http://www.ere.gov.al)

0800 23 23



O O O O

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

# NEWSLETTER

MAJ

2025

## Vendime për çmimet dhe tarifat

Në mbledhjen e datës 12 maj, Bordi miratoi çmimin e shitjes së energjisë elektrike për muajin prill 2025 nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për klientët në nivelin 35 kV, në vlerën 11.51 Lekë/kWh.

U miratuan gjithashtu pagesat rregullatore për vitin 2025 për të gjithë të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror.

## Në konsultim publik:

1. Kontrata tip KESH-FSHU për vitin 2025
2. Komentet e AREA-s mbi kontratën e PP me FTL

**Ftojme të gjithë të interesuarit të vizitojnë faqen tonë zyrtare për të shfletuar të gjitha vendimet, raportet, tarifat dhe publikimet më të fundit:**

[www.ere.gov.al](http://www.ere.gov.al)

0800 23 23

## Pjesëmarrje ndërkombëtare

ERE mori pjesë në një sërë aktiviteteve ndërkombëtare të rëndësishme për sektorin:

- Asambleja e Përgjithshme e ERRA-s – Muskat, Oman
- Takimi rajonal GIZ për Dekarbonizimin – Ohër, Maqedonia e Veriut
- Konferenca Botërore e Gazit #WGC2025 – Pekin, Kinë
- Forumi Evropian i Gazit – Madrid, Spanjë
- Asambleja e Përgjithshme e MEDREG – Antalya, Turqi

**Këto aktivitete ofruan një platformë të rëndësishme për shkëmbimin e përvojës rregullatore dhe forcimin e bashkëpunimit rajonal në sektorin energjetik.**

## Seanca dëgjimore me palët e interesit

Gjatë muajit maj, ERE organizoi 11 seanca dëgjimore me konsumatorë dhe subjekte të licencuara. Çështjet e adresuara përfshinin:

Zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet konsumatorëve dhe operatorëve (FSHU, OSSH)

Zbatimin e intervalit 15-minutësh në tregun balancues

Shqyrtimin e raportit të pajtueshmërisë nga OSSH

Progresin e ankesave dhe masat e ndjekura nga operatorët përkatës